Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Florije Rexhepi	**26.10.2023**	**08.11.2023**	**2023/0804**

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 17.10.2023, OE "Pro & Co Group SH.P.K."- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2023/0804, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë grupi i operatoreve ekonomik "EBK SHPK, U-UNIQUE SHPK, PRO ARK CONSTRUCTION SHPK, BUJAR GODENI P.N H2K1N3, 20000-Prizeren, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Ndertimi i objektit te Gjykates Themelore ne Prizren- Faza e Pare" me nr. të prokurimit: "328-23-6245-5-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Keshilli Gjyqesor i Kosoves.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedure te hapur, lloji i kontratës: punë, vlera e parashikuar e kontratës: 2,500,000.00€.

Datat për fazat e ndryshme të procedurës së tenderit deri në ankesë janë si në vijim: Data e njoftimit për kontratë: 20.06.2023, data e njoftimit per informata shtes ose permisim i gabimit 20.06.2023;data e hapjes së ofertës: 24.07.2023, data e njoftimit mbi vendimin e AK-se: 02.10.2023, data e njoftimit me letër standarde: 02.10.2023.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi
Neni 52 Njoftimi i kritereve për dhënien e kontratës
Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve
Neni 60 Kriteret për Dhënien e Kontratës
Neni 69 Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale
Neni 108A – Zgjidhja Preliminare e mosmarrëveshjeve.

KRITERET PËR VLERËSIM

		Kërkesat e përshtatshmërisë:	Dëshmia e kërkuar dokume
		Deklarata nën betim se ju i përmbushni kërkesat për përshtatshmëri sikurse është	Një deklaratë e shkruar nënshkruar nga tenderue formën në Aneksin e për

11

B17 Dosieja e Tenderit – Pune – Procedur e Hapur

Kontrata Publike: Ndërtimi i objektit të Gjykatës Themelore në Prizren - Faza e Parë, me numër te prokurimit: 328-23-6245-5-1-1, dhe numër te brendshëm: 33300/023/016/511

		cekur në nenin 65 të Ligjit LPP-Nr. 04 L-042.	e tenderit
		Administrata Tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se operatori ekonomik në fjalë nuk është me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tre mujorin e fundit para Njoftimit për Kontrat	Dokumenti duhet të jetë or Ky dokument është obliga nga tenderuesi i cili do të kontratë, dokumenti dorëzo para njoftimit mbi vendimin të dështimit të dorëzimit te tenderi (oferta) në fjalë do të
		Vërtetimin e Gjykatës kompetente. Një dokument te lëshuar nga Gjykata kompetente që përmbush "kërkesat e përshtatshmërisë" Të mos jetë më i vjetër se tre muaj para Njoftimit për Kontrat	Vërtetimin e gjykatës dokument është obligatorë tenderuesi i cili do të kontratë, dokumenti dorëzo para njoftimit mbi vendimin të dështimit të dorëzimit te tenderi (oferta) në fjalë do të

Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale	7.1 & 7.2	Përshtatshmëria profesionale:	*Dëshmia e kërkuar dokume*
		Regjistrimi i OE në regjistrin profesional, komercial ose korporatës në vendin e themelimit	Kopja e certifikatës së regji me totalin e informatave
		Regjistrimi i numrit fiskal	Kopja certifikatës së numr
		Regjistrimi i TVSH-se.	Kopja e certifikatës se TVSH
Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare	8.1 & 8.2	**Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**	*Dëshmia e kërkuar dokumentare*
Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	9.1 & 9.2	Kapaciteti teknik dhe professional:	*Dëshmia e kërkuar dokumenta*
		Operatori Ekonomik duhet ta paraqes një (1) liste	Një (1) Listë e Nënshkru vulosur emrat dhe mbiemrat **e inxhinierve**
		Menaxheri i projektit duhet të jetë inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë ose master i ndërtimtarisë, ose inxhinier i diplomuar i arkitekturës ose master i arkitekturës me përvoje pune se paku Pesë (5) vjeçare pas diplomimit.	1.Të prezantohem CV-ja, përvoja e punës; 2.Diplomat e Inxhinierëve duhet te jene te Noterizuar 3.Të prezantohen Kontrata e rregullt e punës me kompaninë qe oferton te jete e Noterizuar 4.Nga Administrata Tatim ATK) Dëshmi ku vërtetoh kontributet për se paku tre (3) mujorin e Dytë

			(2) 2023.
		OperatoriEkonomik Ofertuesi që oferton është obligatorë të posedojë së paku Një (1) Inxhinier Elektroteknikes i Diplomuar Ose Një (1)Bachelor me Master i Elektroteknikes, me përvoje pune së paku tri (3) vjeçare.	1.Diplomat e Inxhinierit/ve, duhet te jen te Noterizuara, 2.Te prezantohen CV-ja, përvoja e punës; 3.Te prezantohen kontratat e punës ose para kontrata – marrëveshje në emër të projektit me ofertuesin - operatorin ekonomik, si dhe te jene te Noterizuara
		Operatori Ekonomik Ofertuesi që oferton është obligatorë të posedojë Së paku Një (1) Inxhinier i Makinerisë i diplomuar Ose Një(1) Bachelor me Master i Makinerisë, me përvoje pune së paku tri (3) vjeçare.	1.Diplomat e Inxhinierit/ve, duhet te jen te Noterizuara, 2.Te prezantohen CV-ja, përvoja e punës; 3.Te prezantohen kontratat e punës ose para kontrata – marrëveshje në emër të projektit me ofertuesin - operatorin ekonomik, si dhe te jene te Noterizuara

		Operatori Ekonomik Ofertuesi që oferton është obligatorë të posedojë së paku Një (1) Inxhinier i Arkitekturës i diplomuar Ose Një (1) Bachelor me Master i Arkitekturës, me përvoje pune së paku tri (3) vjeçare.	1.Diplomat e Inxhinierit/ve, duhet te jen te Noterizuara , 2.Te prezantohen CV-ja, përvoja e punës; 3.Te prezantohen kontratat e punës ose para kontrata – marrëveshje në emër të projektit me ofertuesin - operatorin ekonomik, si dhe te jene te Noterizuara
		Operatori Ekonomik Ofertuesi që oferton është obligatorë të posedojë së paku Një (1) Inxhinier Ndërtimtarisë I Diplomuar ose Një (1) Bachelor me Master i Ndërtimtarisë me përvoje pune tri (3) vjeçare.	1.Diplomat e Inxhinierit/ve, duhet te jen te Noterizuara , 2.Te prezantohen CV-ja, përvoja e punës; 3.Te prezantohen kontratat e punës ose para kontrata – marrëveshje në emër të projektit me ofertuesin - operatorin ekonomik, si dhe te jene te Noterizuara

		Operatori Ekonomik Ofertuesi duhet te ketë se paku: Njëzet (20) Punëtor Fizik.	1.Një Listë e Nënshkruar paraqiten: Emrat dhe Mbiemrat e Punëtoreve sipas renditjes. 2.Sipas listës me renditje te prezantohen kontratat e punës ose para kontrata – marrëveshje në emër të projektit me ofertuesin – operatorin ekonomik, si dhe te jen te Noterizuara .
		Ofertuesi duhet të ofroj dëshmi se ka kontrat apo kontrata pune të përfunduara te lemisë se ndërtimit tri (3) vitet e shkuara nga Data e Publikimit të Njoftimit për Kontratë, vlera e përgjithshme monetare e punëve te ekzekutuara për operatorin ekonomik ose grupin e operatorëve ekonomik jo më e vogël se **TreMiljonEuro (3,000, 000.00 €).**	Një listë te kontratave të plotësuar Aneksin Shtate Tenderit ku duhet sakt kontratës, shumën e k fillimit, datën e përfundin institucionin e përfituesi renditjes ti bashkëngjite Raporte te Pranimit.

		Operatori Ekonomik - Ofertuesi në ofertë duhet të parages planin dinamik për Ndërtimi i objektit të Gjykatës Themelore në Prizren-Faza e Pare, ne kohëzgjatje JO me Shumë se Njëzet e katër (24) muaj. Nga nënshkrimi i kontratës ne mes Autoriteti Kontraktues: Sekretariati i Këshillit Gjyqësor Kosovës dhe Operatorit Ekonomik: Fitues i Kontratës.	Një Deklaratë e nënshkruar te cilën Operatori Ek deklaron se ne marrim për Objektin e Gjykatës Them Faza e pare, sipas Plan Muajsh kalendar
		Deklaratë me shkrim nga kompania – Operatori Ekonomik se përgjigjet për tri (3) vite për defektet e mundshme për te gjitha punët e kryera pas pranimit teknik të objektit te Gjykatës Themelore - Faza e Parë. , operatori ekonomik është i obliguar ti paraqitet postes zyrtare nga menaxheri i	Deklarata e Nënshkruar d kompania – Operatori Ekon periudhën me kohëzgjatje pas pranimit Teknik nga Au Sekretariati Këshillit Gjyqës brenda njëzet e katër ore (permisimin – intervenimin n Gjykatës Themelore – Faza e Parë.

14

B17 Dosjea e Tenderit – Pune – Procedur e Hapur

Kontrata Publike: Ndërtimi i objektit të Gjykatës Themelore në Prizren - Faza e Parë, me numër te prokurimit: 328-23-6245-5-1-1, dhe numër te brendshëm: 33300/023/016/511

		kontratës që brenda njëzet e katër ore (24 h), të bëjnë permisimin – intervenimin për gjate kohës se periudhës se garantimit për: Tri (3) vite.	

Duke u bazuar në raportin e vlerësimit, komisioni vlerësues ka konstatuar si në vijim:

OE ankues eshte i papërgjegjshëm

OE i rekomanduar për kontrate eshte i pergjegjshem

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

N/A

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

Vendimi nr. OSHP: 2023/0606

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **Pro & Co Group SH.P.K.**

Eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues i pakënaqur me vendimin e AK-se, konform nenit 108/A ka parashtruar ankese ne OSHP, me pretendimin se autoriteti kontaktues – AK - KGJK, nuk i ka respektuar dispozitat e LPP-se, kryesisht nenin 59 të LPP-se, me këtë rast ka rekomanduar për kontrate një operatore ekonomik i cili nuk i plotëson kriteret e dosjes se tenderit.

OE ankues me datën: 02.10.2023, ka pranuar vendimin e AK-se dhe letrën standarde ku AK-ja ,e ka eliminuar me arsyetimin se nuk qe tenderi me çmimin me të ulët.

Pretendimi nr.1

OE ankues GOE Pro & Co Group Sh.P.K. & Floring ShPK & Shkëmbi-Gllarevë ShPK me datën 07/10/2023 ka parashtruar kërkese për rishqyrtim të vendimit në AK- KGJK, ndërsa me datën 11/10/2023, ne si OE ankues pranojmë vendim mbi refuzimin ekërkesës, megjithatë AK nuk i trajton ne tërësi pretendimet tona ankimore dhe me ketë veprim shkele edhe dispozitat e nenit 108/A te LPP-se.Përmes kërkesës për rishqyrtim, ne si OE kemi kërkuar nga AK qe te behet ndarja e projekteve te trajtuara si te mirëqena nga AK, referenca këto për pune te realizuara nga operatore ekonomik tjetër, i cili ka ofertuar dhe është radhitur i dyti për nga çmimi ne këtë procedure te prokurimit "Construmax" Sh.P.K. OE ankues pretendon se AK - KGJK ka pranuar projekte të cilat janë realizuar ne grup - konzorcium dhe te njëjtin projekt e ka vlerësuar si projekt te realizuar nga dy OE-te të cilët kane ofertuar ndaras. Me këto veprime AK ka shkelur paragrafin 9 te nenit 108/A te LPP-se ku shprehimisht potencohet:9. ***"Refuzimi do te arsyetohet dhe do ti komunikohen me shkrim, në përputhje me këtë ligj, parashtruesit të ankesës dhe të gjitha palëve të interesuara, nëse ka ndonjë "***

Përveç se nuk janë trajtuar pretendimet ankimore ashtu siç neve kemi kërkuar, AK - KGJK vendimin mbi refuzim e ka nxjerre ne kundërshtim me afatin e parapare dhe te përcaktuar ne paragrafin 6 ku përcaktohet:6. ***"Autoriteti kontraktues do ta shqyrtojë kërkesën brenda tre (3) ditë pune nga data e dorëzimit të aplikimit ose, kur është e zbatueshme, nga data e marrjes së informative shtesë dhe dokumenteve të parashikuara në paragrafin 5 të këtij neni."***

Kërkesa për rishqyrtim është parashtruar me datën 07/10/2023 ndërsa vendimi është nxjerre me datën 11/10/2023.

Eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues me datën 07.10.2023 ka parashtruar kërkesën për rishqyrtim ndërsa AK-KGJK me datën 11.10.2023 nxjerr vendimin mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim duke refuzuar ne tersi kërkesën si të pabazuar dhe njeherit ne arsyetimin e vendimit te lëshuar nga AK-ja, janë dhëne përgjigjet ne pretendimet ankimore te OE ankues.

Pretendimi nr.2

AK - KGJK, tek kërkesat e kapacitetit teknik dhe profesional keni kërkuar:

Ofertuesi duhet të ofroj dëshmi se ka kontratë apo kontrata pune të përfunduara te lenisë se ndërtimit tri (3) vitet e shkuara nga Data e Publikimit të Njoftimit për Kontratë, vlera e përgjithshme monetare e punëve te ekzekutuara për operatorin ekonomik ose grupin e operatorëve ekonomik jo më e vogël se Tre Milion Euro (3,000, 000.00 e). Dëshmia:

Një listën te kontratave të realizuara duke plotësuar Aneksin Shtate (7) te Dosjes se Tenderit ku duhet saktësuar: Titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e fillimit, datën e përfundimit dhe emrin - institucionin e përfituesin. Listës sipas renditjes ti bashkëngjiten Referencat ose Raporte te Pranimit.

OE ankues pretendon se AK – KGJK, Pra përmes ri vlerësimit te ofertave AK ka shkelur nenin 52, 56, 59 dhe 69 te LPP-se, pasi qe grupi i OE- ve te rekomanduar për dhënie te kontratës nuk ka prezantuar dëshmi përmes te cilave mbulohet vlera e kërkesës dhe periudha kohore.

Me datën 23.06.2023, është publikuar njoftimi për kontrate, projektet janë kërkuar për periudhën kohore 3 vite pas publikimit te njoftimit për kontrate.Lideri i grupit te OE te rekomanduar për dhënie te kontratës ka prezantuar projekte te cilat shumica nga to janë te realizuara nga operatori tjetër ekonomik i radhitur i dyti për nga çmimi "Construmax" SHPK. AK të njëjtën reference dhe te njëjtin projekt i ka pranuar si te mirëqenë për dy operatoret ekonomik veç e veç.

Disa nga projektet e realizuara si të përbashkëta;

Renovimi i Komunës - Përdhesës dhe kulmit ne Prizren, aneks kontratat për ketë projekt Loti 1 dhe 2,

Ndërtimi i sallës se edukatës fizike ne shkollën Dëshmoret e Zhuritfaza II është projekt i përbashkët

Ndërtimi i ndërtesave qeveritare dhe institucioneve Arsimore, kontratë kjo e lidhur me Ministrinë e Administratës Publike — MAP etj.

AK - KGJK **ligjërisht do te duhej te bënte ndarjen e punëve te realizuara** nga OE-te EBK dhe Construmax Sh.P.K., konkretisht ne kuptim te nenit 59 dhe 72 te LPP-se, te kërkonte sqarim raporte te pranimit teknik te punëve, transaksione bankare apo edhe marrëveshjet e konzorciumit ne atë mënyrë qe te verifikonte nëse OE i rekomanduar për dhënie te kontratës e plotëson kërkesën dhe vlerën kualifikuese te përcaktuar ne dosje te tenderit dhe ne njoftimin për kontrate, Kjo çështje nuk është trajtuar fare me kërkesën për rishqyrtim dhe nuk është dhëne argument ligjore mbi arsyet e refuzimit te kërkesës tonë.Për këtë çështje ekzistojnë interpretime te KRPP-se dhe vendime te OSHP-se ku kanë gjykuar ndryshe nga AK.Si prove përveç shume vendimeve te publikuara ne ueb-faqe te OSHP-se për konsistence mund ti referoheni vendimit me numër 1041/20 te datës 17/12/2020.Për me tepër grupi i OE-ve te rekomanduar për kontrate ka prezantuar projekte te cilat ende nuk janë te përfunduara apo ne realizim e sipër, ndërsa AK — KGJK ka pranuar te njëjtat projekte, ka pranuar fatura te cilat nuk korrespondojnë me kërkesën kualifikuese te përcaktuar ne dosje te tenderit.

Eksperti shqyrtues, lidhur me ketë pretendim sqaron se konzorciumi OE i rekomanduar për kontrate, për periudhën e kërkuar nga autoriteti kontraktues, lidhur me kontratat dhe referencat, sqaron se e ka dorëzuar një liste të kontratave me vlere prej:

Lideri OE EBK, ka dorëzuar listën e kontratave ne vlere prej: 3,760,854.87 euro.

Anëtari i konzorciumit U-Unique: 720,356.33 euro.

Anëtari tjetër i konzorciumit Pro ARK Construction: 1,580,000.00 euro.

Totali: 6,063,211.20 euro.

Eksperti shqyrtues vlerëson si te pa bazuar pretendimin e OE ankues për faktin se konzorciumit ne fjale ka dorëzuar kontrata dhe referenca me vlere shume here me te larte se sa ka kërkuar autoritetit kontraktues dhe njeherit sqaroj se pretendimi për te ndare vlerat e kontratave ne rast është i paqëndrueshëm sepse vlera e kontratave te dorëzuara nga konzorciumi i rekomanduar për kontrate e tejkalon vlerën prej: 3,000,000.00 euro.

Poashtu nuk qëndron pretendimi nr. 4 te OE ankues, i cili pretendon ngjashëm sikurse edhe te oferta e te rekomanduarit për kontrate, kërkon qe edhe OE Construmax (i renditur i dyti sipas çmimit) ti ndahen vlerat e kontratave.

Pretendimi nr. 3

Tek kërkesat e kapacitetit teknik dhe profesional AK — KGJK ka kërkuar edhe staf të kualifikuar përfshirë menaxher te projektit, dëshmi, kontrata te punës, marrëveshje, CV-te, te nënshkruara dhe te noterizuara. OE i rekomanduar për dhënie te kontratës ka prezantuar menaxher të projektit ku shifet qarte se dallojnë nënshkrimet nga marrëveshjet e bashkëpunimit, kontrata dhe CV-ja, rrjedhimisht jo te gjitha shkresat dhe dokumentet e dedikuara për nënshkrim nga menaxheri i prezantuar i projektit nuk janë te nënshkruara personalisht, dhe nga kjo neve si kompani kemi dilemat tona se i njëjti OE ne oferte ka prezantuar shkresa fiktive.

Eksperti shqyrtues, ne përgjigje te pretendimit te OE ankues, me datën: 06.11.2023, i është drejtuar me shkrim menaxherit te projektit z. Bekim Mujajt, për te dhënë sqarimin se a janë nënshkruar dëshmitë e dorëzuara ne oferte nga ana e vet z. Mujaj.

Ne përgjigje z. Mujaj ka deklaruar:

Përshëndetje

Duke ju përgjigjur kërkesës tuaj, konfirmoj që të gjitha dokumentet e dorëzuara nga GOE: EBK&U-Unique&Pro Ark Construction për tenderin: Titulli: Ndërtimi i objektit të Gjykatës Themelore në Prizren- Faza e Parë dhe nr. Prokurimit:328-23-6245-5-1-1 janë të nënshkruara nga ana ime.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues refuzohet si e pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **Këshilli Gjyqësor i Kosovës**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **Pro & Co Group SH.P.K.**

REPUBLIKA E KOSOVËS
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
PRISHTINË/A
REPUBLIKA KOSOVA

Florije Rexhepi